



Pranuar / Dorezuar Puniljenor/Prodatur Received/Delivery	12.04.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK/3463/2023			1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.353/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.353/2023 të datës 13.02.2023 të parashtruar nga ankuesja , me adresë fshati Korishtë në Komunën e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 12.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.353/2023 e datës 13.02.2023 e parashtruar nga ankuesja . . .

II. Anulohet konkursi i datës 23.05.2023 sipas numrit të referencës RN00009094 për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Qendra për Punë Sociale, i shpallur nga Komuna e Prizrenit si dhe shfuqizohen të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Prizrenit, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 23.05.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 13.06.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale me numër të referencës RN00009094 lidhur me pozitat "Zyrtar për shërbime sociale" në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Qendra për Punë Sociale, për klasën e pozitës Profesional 2.

Ankuesja me datën 04.05.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qene e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 24.01.2023 e gjeneruar tek SIMBNJ nga ana e komunës së Prizrenit, e njëjta është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 73.4 pikë, duke u renditur e treta (3) në këtë listë.

E pa kënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar nga ana e komisionit të pranimit, me datën 26.01.2023, ankuesja ka parashtruar ankesë tek Komisioni për pranim, me pretendimet ankimore kundër vlerësimit të procesit të intervistës me gojë dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Rregullores 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Me datën 01.02.2023, Komisioni për pranim përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Prizrenit, ka nxjerrë Vendimin me Nr.RN00009094, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuses si të pabazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit në Komunën e Prizrenit lidhur me refuzimin e ankesës se saj si dhe njoftimit lidhur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.02.2023 përmes Postës së Kosovës, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1697/2023 e cila me datën 13.02.2023 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit Nr.06-L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 20.02.2023 ankesën e ankuses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa me datën 14.03.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.03.2023 me Vendimin me numër protokollit 3118/2023 ka vazhduar afatin për vendimarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.353/2023 të datës 13.02.2023, të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:1697/2023 të datës 13.02.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.RN00009094 të datës 01.02.2023 të Komisionit të Pranimit; Kopjen e konkursit me numër të referencës RN00009094 të datës 23.05.2022; Njoftimin mbi rezultatet e verifikimit paraprak të datës 30.06.2022 për ankuesen; Njoftimin e datës 27.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me përpilimin e listës së ngushtë; Njoftimin e datës 04.07.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me përpilimin e listës së ngushtë përfundimtare; Njoftimin mbi mbajtjen e testimit me shkrim për ankuesen të datës 11.07.2022; Njoftimin për rezultatet e testimit me shkrim për ankuesen të datës 11.09.2022; Njoftimin mbi rezultatin e CV-së për ankuesen të datës 20.01.2023; Aplikacionin për punësim të ankueses të datës 14.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale, të punës si dhe certifikatat e trajnimeve; Njoftimin lidhur me pjesëmarrjen në intervistën me gojë të ankueses të datës 20.01.2023; Njoftimin lidhur me rezultatet e intervistës me gojë të ankueses të datës 24.01.2023; Njoftimin e datës 24.01.2023 lidhur me përfundimin e vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me fitues për pozitën e lartcekur i lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Ankesën e ankueses të datës 26.01.2023 e parashtruar tek Komisioni i Pranimit; Kërkesën e datës 25.01.2023 e parashtruar nga ankuesja lidhur me qasjen në dokumente publike; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 25.01.2023 e parashtruar nga ankuesja; Listën me renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 24.01.2023 e gjeneruar tek SIMBNJ; Rezultatet e vlerësimit të biografisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.03.2023 nga Komuna e Prizrenit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin Nr.RN00009094/01 të datës 30.06.2022 lidhur me themelimin e komisionit të pranimit; Akt emërimin me numër AE.Nr.01-030/01-95982 të datës 29.06.2022 për SH.B; Vendimin Nr.01-111-63265/02 të datës 26.05.2022 lidhur me pranimin e ekspertit të jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore; Akt emërimin e datës 04.01.2012 për M.ZH; Akt emërimin me numër AE.Nr.01-112-133636 të datës 01.09.2022 për A.A; Akt emërimin me numër AE.Nr.01-112-160101 të datës 10.11.2022 për K.B; Listën e aplikantëve me kandidatët e aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar tek SIMBNJ; Aplikacionin për punësim të kandidatës I.V së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale, të punës, pasqyrën e llogarisë nga trusti, certifikatat e trajnimeve, ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile, vërtetimin lidhur me evidencën penale nga Policia e Kosovës; Aplikacionin për punësim të kandidatës V.B të datës 20.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale, të punës, pasqyrën e llogarisë nga trusti si dhe certifikatat e trajnimeve; Konkursin me numër të referencës RN00008731 të datës 30.03.2022; listën me aplikacionet e pranuar të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Shkresën e datës 22.04.2022 lidhur me dokumentin e verifikimit paraprak dhe Njoftimin e datës 06.05.2022 lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve si dhe Vendimin VK/2023 të datës 29.03.2023 lidhur me vazhdimin e afati të ankesës së ankueses në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses _____ është e bazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit

„Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale’, në Komunën e Prizrenit, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00009094 lidhur me dy pozitë “Zyrtar për shërbime sociale 2” në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Qendra për Punë Sociale, për klasën e pozitës Profesional 2, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to-Fakulteti Juridik, Psikologji, Punë Sociale dhe Sociologji.*
- *Kualifikime të posaçme: Nuk ka*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën e lartcekur, ka analizuar afatshmërinë e kësaj procedure dhe ka konstatuar se që nga data e hapjes për aplikim të konkursit 13.06.2022 e deri në përfundimin e procedurës me shpalljen e Njoftimit për përfundimin e vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me kandidatet fitues të datës 24.01.2023 i shpallur nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit për pozitën e lartcekur, ka konstatuar se kanë kaluar më tepër se tetë (8) muaj e krejt kjo në kundërshtim me dispozitat e nenit 98 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet se: “2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”, ngase procedura e rekrutimit për pozitën në fjalë nuk është zhvilluar brenda afateve ligjore, për faktin se nga shkresat lëndës të dërguara nga ana e organit të punësimit, nuk kemi dëshmi se ka pasur ankesa në fazën e verifikimit paraprak tek ky institucion që kishte me ndikuar në vonesa të procesit apo edhe në përfundim të procedurës së vlerësimit përveç ankesës së ankuseses tanimë në Këshill.

Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve të përfshirë në listën e ngushtë, ka gjetur se njësia përgjegjëse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike sepse bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas dëshmive të dorëzuara nga kandidatët me rastin e aplikimit, është konstatuar se kandidatja e përzgjedhur Iliriana Vataj në këtë rast si njëra ndër kandidatet fituese për pozitën në fjalë, lidhur me përvojën e punës ka prezantuar Vërtetimin e datës 17.06.2022 të lëshuar nga Drejtori i ABI Sh.P.K-L.L.C me seli në Prizren si dhe pasqyrën e trustit për periudhën nga data 11.09.2022 deri më 12.06.2022, sipas se cilës theksohet se e kandidatja në fjalë ka qenë në marrëdhënie të punës në ABI Sh.P.K në Prizren në njësinë Abi Plus në Prizren dhe atë duke filluar nga data 01.07.2016 deri më 31.05.2019, sipas se cilit vërtetim theksohet se e njëjta ka kryer detyra shtesë nga lëmija e shërbimeve sociale, veçmas në aftësimin e punëtoreve të reja për kryerjen e detyrave sipas udhëzimeve të udhëheqësve të sektorit posaçërisht në zhvillimin e planeve të punës me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës në përgjithësi, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit si dhe duke u bazuar edhe në konstatimin e Gjykatës së Apelit sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022, vërtetimi lidhur me përvojën e punës në sektorin privat nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme për të provuar faktin e përvojës së punës pasi që e njëjta nuk është e shoqëruar me kontratë të vlefshme mbi lidhjen e marrëdhënies së punës me të cilën dëshmohet pozita të cilën e ka mbajtur kandidatja në fjalë si dhe të theksohet përshkrimi i detyrave të punës sipas së cilës ka qenë e ngarkuar e njëjta për kryerjen e detyrave të punës. Andaj nisur nga ky fakt Kolegji konstaton se kandidatja e përzgjedhur nuk i ka plotësuar kushtet e

konkursit sa i përket përvojës së punës prej dy (2) vitesh ashtu siç është kërkuar me konkurs dhe me këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prizrenit me rastin e përfshirjes së kandidates Iliriana Vataj në listën e ngushtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 1, 2, dhe 3 si dhe nenin 56 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 57 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe me rastin e përzgjedhjes të së njëjtës si kandidate fituese Komisioni i Pranimit të Komunës së Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj, Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 23.05.2022 sipas numrit të referencës RN00009094 për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale nga Komuna e Prizrenit lidhur me dy (2) pozitat për Zyrtar për Shërbime Sociale 2, në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Qendra për Punë Sociale, për klasën e pozitës Profesional 2 në Komunën e Prizrenit është bërë në kundërshtimin me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë edhe ka vendosur t'a anulojë konkursin e lartë cekur si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, kurse ankesa e ankueses është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture. Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, meqenëse shpallja e konkursit nuk ka qenë në harmoni me dispozitat e akteve ligjore të përcaktuara si më lartë.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji duke u bazuar në Nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.353/2023, datë 12.04.2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.